



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.DH.ShII.nr.679/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit Avokat Labinot Vata me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Marigona Berisha, avokate nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë -Departamenti i për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.974/23 të datës 10.01.2024, me datë 30.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Av. Labinot Vata me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Marigona Berisha, avokate nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë -Departamenti i për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.974/23 të datës 10.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë -Departamenti i për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.974/23 të datës 10.01.2024, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Fushë Kosovës, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.285/23 të dt. 15.05.2023 të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe ta refuzoj prapësimin ose çështjen ta kthej në shkallë të parë në rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Av. Labinot Vata me datën 21.04.2021, ka paraqitur propozimin për përbarim mbi bazën e dokumentit përbarimor, Marrëveshjes për ndërmjetësimin me numër 021/2022, e datës 27.12.2022, ka lejuar Urdhrin Përbarimor P.nr. 280/23, të datës 15.05.2023, ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës për pagimin e shumës prej EUR 312.00, së bashku me shpenzimet e procedurës përbarimore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përbarim në lartësi prej EUR 117.00.

Përbaruesi Privat Blerim Baloku me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin përbarimor P.nr.285/23 të dt. 15.05.2023 e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përbarimit dhe ka shtuar se marrëveshja mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk përbën dokument përbarimor ngase e njëjta ka parregullsi. Me tej, ka theksuar se kreditori nuk i është drejtuar debitorit me kërkesë zyrtare apo me ndonjë faturë. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri

përbarimor të anulohet. Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori duke theksuar se debitori nuk ka paraqitur asnjë shkak mbi bazën e së cilit mund të anulohet urdhri përbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa ka shtuar se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përbarimor përbën dokument përbarimor, i cili përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë dhe se i njëjti ka fuqinë e dokumentit përbarimor në përputhje me dispozitat e LPP-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa i ka kërkuar edhe shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në lartësi prej EUR 234.00.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 21 të LPP-së, “Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa, me nenin 22, pika 1.4 të Ligjit për procedurën përbarimor, lidhur me nenin 5.1 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi procedurën përbarimore, është përcaktuar si dokument përbarimor edhe marrëveshja e lidhur në procedurë të ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin.

Shkalla e parë në rastin konkret ka shqyrtuar dokumentin përbarimor Marrëveshje e ndërmjetësimit nr. 021/2022 e datës 27.12.2022 mbi bazën e së cilës është lejuar përbarimi, dhe gjeti se palë kontraktuese, përkatësisht kreditor në këtë marrëveshje paraqiten personat fizik E.Q., A.T., A.XH., E.G. dhe B.G., të përfaqësuar nga avokat Labinot Vata si dhe Komuna e Fushë Kosovës në anën tjetër në cilësi të debitorit.

Tutje shkalla e parë gjen se kreditori i listuar në propozimin për përbarim avokat Labinot Vata, nuk është palë në marrëveshjen e ndërmjetësimit mirëpo që i njëjti ka vepruar në cilësi të të autorizuarit të palëve, ashtu që i njëjti nuk është person i autorizuar që të kërkoj realizimin e detyrimit monetar prej EUR 312.00 ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës, ngase nuk është titullar të se drejtës së përcaktuar në dokument përbarimor, përderisa kërkesa monetare i është

njohur palëve pjesëmarrëse në procedurën e ndërmjetësimit si shpenzim për përpilimin e padisë nga ana e përfaqësuesit të autorizuar. Andaj meqenëse ekzekutimi i dokumentit përmbartimor mund të lejohet vetëm në dobi të personit i cili sipas dokumentit përmbartimor është i autorizuar të kërkojë përmbartjen nga debitori i përcaktuar në dokument përmbartimor, në rastin konkret vetëm në dobi të palëve në marrëveshje dhe jo kreditorit si në propozim për përmbartim, gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, paragrafi 1, pika 1.6, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se “prapësimi mund të bazohen vetëm nëse”, ndër të tjera, “kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin kundër debitorit”. Rrjedhimisht, edhe urdhri përmbartimor duhet të anulohet për ngase kreditori në propozim për përmbartim nuk e ka cilësinë e kreditorit në dokumentin përmbartimor mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, dokument përmbartimor me marrëveshjen e ndërmjetësimit duke ju referuar nenit 21 të LPP-së, “Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa, me nenin 22, pika 1.4 të Ligjit për procedurën përmbartimor, lidhur me nenin 5.1 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi procedurën përmbartimore, është përcaktuar si dokument përmbartimor edhe marrëveshja e lidhur në procedurë të ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin. Por, meqenëse ekzekutimi i dokumentit përmbartimor mund të lejohet vetëm në dobi të personit i cili sipas dokumentit përmbartimor është i autorizuar të kërkojë përmbartjen nga debitori i përcaktuar në

dokument përmbartimor, në rastin konkret vetëm në dobi të palëve në marrëveshje dhe jo kreditorit si në propozim për përmbartim, edhe kjo gjykate vlerëson se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, paragrafi 1, pika 1.6, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se “prapësimi mund të bazohen vetëm nëse”, ndër të tjera, “kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin kundër debitorit”

Pretendimi ankimor i kreditorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave kur ka vendosur mbi mospranimin e dokumentit përmbartimor me marrëveshjen e ndërmjetësimit. Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, ngase sipas dispozitave të lartcekura nga kjo marrëveshje personi i tretë në këtë rast avokati Labinot Vata nuk është autorizuar të kërkojë përmbartimin kundër debitorit dhe nuk mund të pranohen si dokumente i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përmbartimore. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale,

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Sh II.nr.679/24, me datë 30.05.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti